



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/.nr.20/24

AUTORITETI KOMPETENT I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - Kryetarja e Gjykatës Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga H.S, ndaj gjyqtarit A.H, bazuar në dispozitën e nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, me datë 27.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e ushtruar nga H.S ndaj gjyqtarit A.H, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 10.09.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga H.S, ndaj gjyqtarit A.H, me arsyetimin se në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë është duke u zhvilluar procedura kontestimore në lëndën me numër C.nr.1015/24, me bazë juridike vërtetim pronësie me propozim për caktim të masës së sigurimit, në të cilën lëndë gjykata ka vepruar me urgjencë edhe pse ka lëndë të tjera disa vite më të vjetra se kjo lëndë, ende të pa trajtuara, duke theksuar se pavarësisht faktit se ka paraqitë kërkesë për shtyrje të seancës duke ia dorëzuar dokumentet mjekësore lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe Vërtetimin për vdekjen e nënës së tij, gjyqtari A.H duke mos e përfillë këtë kërkesë, pa dijeninë dhe prezencën e tij si palë apo të autorizuarit të tij, gjatë kohës sa ai ka qenë duke pritë në të pamën e nënës së tij të ndjerë, gjyqtari ka dalë në vend shikim dhe ka nxjerrë vendim të kundërligjshëm për caktimin e masës së sigurimit dhe atë jo vetëm për pjesën kontestuese por edhe për pjesën tjetër të trullit edhe pse kjo është çështje e gjykuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Andaj, nga rrethanat e mësipërme vlerëson se gjyqtari është subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional, pasi ka vepruar në shkelje të plotë të dispozitave ligjore duke mos nxjerrë vendim për hedhje të padisë dhe propozimit si të palejuar për shkak të çështjes së gjykuar me vendim të formës së prerë, veprim ky i cili konsiston në shkelje të nenit 5 par.2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse dalja në vendngjarje pa prezencën e tij si palë konsiston në shkelje të parimit ex-parte nga neni 5 par.2 pika 2.8 të Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe

Prokurorëve. Gjithashtu, ka theksuar se edhe vendimi i Nënkyetarit të Gjykatës për refuzim të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit është i kundërligjshëm dhe se thirrjen për gjykim e ka pranuar ende pa e pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për përjashtim. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave ka propozuar që ankesa e tij disiplinore të aprovohet si e bazuar. Si provë ka bashkëngjitur Aktvendimin C.nr.1015/24, të datës 03.07.2024 për caktim të masës së sigurimit

Me datë 16.09.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga H.S ndaj gjyqtarit A.H.

Gjyqtari A.H në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës fillimisht në lidhje me pretendimin se lënda është trajtuar me urgjencë ndërsa ka edhe lëndë të tjera pa u trajtuar edhe pse janë disa vite më të vjetra se kjo lëndë, ka vënë në dukje faktin se në çështjen në fjalë është trajtuar vetëm propozimi për masë të sigurisë e cila duhet të trajtohet me urgjencë, e jo edhe çështja kryesore. Sa i përket pretendimit se seancat e caktuara nuk janë shtyrë edhe pse i njëjti ka parashtruar kërkesë për shtyrjen e tyre, gjyqtari ka theksuar se në lënë në fjalë janë mbajtur gjithsej tri seanca, ashtu që seanca e parë është mbajtur si seancë dëgjimore me datën 13.06.2024, në të cilën pala në fjalë ka paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës me arsyetimin se për arsye dhe shkaqe të arsyeshme nuk mund të paraqitet në seancë, mirëpo duke mos i elaboruar arsyet dhe duke mos ofruar dëshmi, andaj gjykata kërkesën në fjale nuk e kishte marr parasysh si dhe bazuar në natyrën e çështjes dhe pretendimet në propozim, kishte vlerësuar se e njëjta kërkesë është vetëm përpjekje për zvarritje të procedurës. Tutje, ka theksuar se në seancën e dytë të datës 19.06.2024, të mbajtur si seancë për dalje në vend shikim, e njëjta palë po ashtu kishte paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës dhe përjashtimin e tij si gjyqtar, në kërkesën për shtyrje i njëjti kishte theksuar se është në gjendje jo të mirë shëndetësore si dhe ka theksuar se ka nguti nga ana e gjykatës pasi që janë caktuar 3 seanca brenda 20 ditësh (e që në fakt ishte seanca e dytë e caktuar) si dhe ka kërkuar që seanca të shtyhet për së paku 30 ditë, e të cilën kërkesë e ka refuzuar me aktvendimin e dhënë në seancë, duke vlerësuar se kemi të bëjmë me çështje të natyrës urgjente si dhe duke vlerësuar se kërkesa e tillë është bërë vetëm për qëllim të zvarritjes së procedurës, duke pasur parasysh situatën e paraqitur në propozim për caktimin e masës. Sa i përket kërkesës për përjashtimin e tij si gjyqtar nga shqyrtimi i lëndës, gjyqtari ka sqaruar se menjëherë e ka njoftuar Kryetaren e Gjykatës për vendosje të mëtejme dhe kjo kërkesë për përjashtim është refuzuar. Sa i përket seancës së tretë të mbajtur si seancë dëgjimore me datën 26.06.2024, gjyqtari ka deklaruar se e njëjta palë, sipas fletë kthesës e kishte refuzuar marrjen e ftesës për seance, për çka në përputhje edhe me praktikën në gjykatë e ka konsideruar si thirrje të rregullt dhe e ka mbajtur seancën në mungesën e tij. Duke i pasur parasysh të lartcekurat në lidhje me seancat e mbajtura, pretendimet e palës në fjalë në lidhje me caktimin e seancave dëgjimore dhe dalje në vend shikim në ditët e të pames së vdekjes së nënës së tij, gjyqtari deklaroi se janë tërësisht të pavërteta, pasi që gjykata seancën e fundit e ka caktuar me datën 26.06.2024, ndërsa nëna e tij sipas ankesës në fjalë, kishte vdekur me datën 27.06.2024, pra një ditë më vonë, e për të cilën seancë pala e kishte refuzuar pranimin e ftesës dhe gjykata nuk ishte në dijeni në lidhje me rrethanat për nënën e tij. Sa i përket pretendimit që seancat ishin mbajtur pa prezencën e të autorizuarit të tij, gjyqtari ka theksuar se edhe në këtë pikë parashtruesi i ankesës nuk tregohet i sinqertë, pasi që fillimisht i njëjti nuk e kishte paraqitur asnjë autorizim për përfaqësim dhe së dyti, i njëjti parashtruesat (kërkesat për shtyrje, përjashtim të gjyqtarit) i kishte përpiluar te një avokat i caktuar dhe ishte paraqitur një herë në gjykatë me avokatin në fjalë, ku gjyqtari nuk ka qenë prezent në atë moment e edhe po

të ishte nuk do të takohej me qëllim të evitimit të kontakteve ex parte me palët. Për më tepër, gjyqtari ka shtuar se sipas deklarimeve të avokatit në fjalë, pala ankuese asnjëherë nuk ka pranuar që ta autorizojë të njëjtin për përfaqësim në lëndën në fjalë. Andaj, vlerëson se mospjesëmarrja e tij në seancë dhe mos autorizimi i një personi tjetër në lidhje me çështjen në fjale ka pas për qëllim që të zvarriste procedurën dhe eventualisht të ankohet për marrjen e vendimit pa prezencën e tij, siç është vepruar deri me tani. Ndërsa, sa i përket pretendimit të çështja ishte vendosur një herë, gjyqtari ka theksuar se në të njëjtën çështje ishte vendosur në procedurë jokontestimore, ndërsa çështja në fjalë ka qenë çështje kontestimore e cila e konsumon procedurën jokontestimore dhe nuk ka të bëjë me çështje të gjykuar. Në këtë pikë, gjyqtari ka theksuar po ashtu se pala në fjalë, ende pa marrë vendim në lidhje me propozimin për caktimin e masës, kishte shkuar në polici për ta paraqitur si rast kundër gjyqtarit në lidhje me lëndën konkrete, të cilin veprim gjyqtari e vlerëson si një lloj presioni apo tentim për ta frikësuar në vendosjen e çështjes në fjalë. Lidhur me vendimin për caktim të masës me pretendimet e njëjta, gjyqtari ka theksuar se pala është ankuar edhe në Gjykatën e Apelit, po ashtu pala e njëjtë për pretendimet e njëjta, kishte paraqitur edhe kërkesë për përjashtimin e tij si gjyqtar nga shqyrtimi i çështjes në fjale, e cila kërkesë ishte refuzuar rrjedhimisht, konsideron se kjo ankesë bashkë me ankesat - kërkesat e tjera të paraqitura në lidhje me këtë çështje (si në gjykatë ashtu edhe në polici), janë kërkesa që nuk bazohen në të dhëna të vërteta, e po ashtu janë të pabazuara dhe qëllimi i tyre është bërja presion ndaj gjyqtarit të çështjes, për të vendosur sipas dëshirës së palës, gjegjësisht për refuzimin e propozimit për masë apo refuzim të kërkesëpadisë. Përfundimisht, ka theksuar se vlerëson se të gjitha palët në këtë procedurë, janë trajtuar konform ligjit, për më tepër është eliminuar çfarëdo komunikimi ex-parte lidhur me lëndën, edhe pse siç u sqarua më lartë ka pasur tentim nga vetë pala ankuese se bashku me avokatin që ia ka përpiluar shkresat, që të takohen personalisht në zyrën e gjyqtarit.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, autoriteti kompetent vlerësoj ekzistimin e shkeljeve të mundshme cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (tutje: Ligji), me theks të veçantë në vlerësimin e ekzistimit të mundshëm të elementeve të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga parashtruesi i ankesës nga neni 5 paragrafi 2 pika 2.2 dhe 2.8 të Ligjit.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.H.

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjyqtari ka kryerje shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.2 të Ligjit, sipas të cilit: “Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: 2.2. nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë”, me arsyetimin se gjyqtari ka vepruar me urgjencë në çështjen ku këtu parashtruesi i ankesës është palë edhe pse ka lëndë të tjera më të vjetra ende të patrajtuara si dhe është subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional pasi ka vepruar në shkelje të plotë të dispozitave ligjore duke mos nxjerrë vendim për hedhje të padisë dhe propozimit si të palejuar për shkak të çështjes së gjykuar me vendim të formës së prerë, autoriteti kompetent gjeti se pretendimet e tilla janë të pabazuara, për arsyet si në vijim:

Në raport me pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtari ka trajtuar me urgjencë lëndën e tij edhe pse ka lëndë të tjera më të vjetra ende të pa trajtuara, autoriteti kompetent gjen se në çështjen juridiko civile në të cilën këtu ankuesi është palë, krahas padisë është parashtruar edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë e të cilin propozim konform dispozitave ligjore, gjykata është e obliguar t'a trajtoj me urgjencë pasi afatet ligjore të përcaktuara për shkak të natyrës së rastit janë më të shkurtra, andaj në rrethana të tilla trajtimi dhe vendosja e kërkesës për caktim të masave për sigurimin e kërkesëpadisë nuk i nënshtrohet rregullit të trajtimit sipas radhës së pranimi të lëndës në gjykatë.

Kurse, në vlerësim të pretendimit të parashtruesit të ankesës se gjyqtari është subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional pasi ka vepruar në shkelje të plotë të dispozitave ligjore duke mos nxjerrë vendim për hedhje të padisë dhe propozimit si të palejuar për shkak të çështjes së gjykuar me vendim të formës së prerë, autoriteti kompetent gjen se vendimmarrja është autorizim i gjyqtarit që buron nga ligji, duke rikujtuar se me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, me të cilën përcaktohet se: “Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave e duke pas parasysh se ankuesi me asnjë provë dhe në asnjë mënyrë nuk e argumentoj faktin se vendimi i tillë i gjyqtarit është marrë si pasojë e rrethanave të cilat hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, autoriteti kompetent vlerëson se pakënaqësitë e palës ndaj vendimit të gjyqtarit mund të jenë bazë për të ushtruar mjet juridik për të cilin vendosin instancat më të larta gjyqësore, por nuk mund të jetë bazë për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit të çështjes. Po ashtu, parashtruesi i ankesës në parastresën e tij nuk i ka argumentuar as pretendimet e tij se gjyqtari është subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional, andaj në rrethana të tilla e në mungesë të provave, ankesa disiplinore e mbështetur në këto pretendime u refuzua si e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.8 të Ligjit, sipas të cilit: “Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: 2.8. *përfshihet në çfarëdo komunikimi ex-parte, lidhur me lëndët;*” me arsyetimin se gjyqtari nuk e ka përfillë kërkesën e tij për shtyrje të seancës dhe ka dalë në vend shikim pa dijeninë dhe pa prezencën e tij apo të autorizuarit të tij, autoriteti kompetent gjeti se përtej faktit se kërkesa për shtyrje të seancës nuk ishte e arsyetuar dhe e mbështetur në prova konkrete dhe faktit se këtu parashtruesi i ankesës nuk rezultoi të ketë të autorizuar për përfaqësimin e tij në çështjen juridiko – civile kontestimore të cilës i referohet, është e rëndësishme të sqarohet se komunikimi ex-parte nënkupton komunikimin e gjyqtarit me njërin palë pa prezencën e palës tjetër apo të autorizuarit të tij. Në këtë pikë, duke qenë se gjyqtari i çështje ka kompetencë dhe autorizim që buron nga ligji që të vlerësoj kërkesën për shtyrje të seancës dhe sipas bindjes së tij, e duke marrë parasysh rrethanat e rastit, të vendos se a do ta shtyjë seancën apo jo, kurse mbajtja e seancës në prezencën apo mungesën e palëve ndërgjyqëse është e rregulluar me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shkelja e të cilave mund të jetë bazë për të parashtruar mjete juridike për të cilat vendosin gjykatat e instancave më të larta, por nuk mund të jenë bazë për të

parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit e aq më pak të interpretohet si komunikim ex-parte me palën, fakti i mbajtjes së seancës në mungesë të njërës palë (rrethanë kjo e rregulluar me ligj).

Autoriteti kompetent vlerësoj edhe pretendimin e parashtruesit të ankesës se vendimi i Nënkyetarit të Gjykatës për refuzim të kërkesës së tij për përjashtim të gjyqtarit ka qenë i kundërligjshëm dhe gjeti se ky pretendim është tejet i përgjithësuar dhe i pa arsyetuar dhe se autoriteti kompetent për trajtimin e ankesave disiplinore nuk ka kompetencë për të trajtuar saktësinë dhe ligjshmërinë e vendimeve të tilla, andaj nuk u lëshua në elaborimin e mëtejme të tij në këtë procedurë disiplinore.

Mbi bazën e të lartcekurave, autoriteti kompetent me asnjë provë dhe në asnjë mënyrë nuk u bind se gjyqtari A.H me veprimet e tij me dashje apo nga pakujdesia nuk i ka trajtuar siç kërkohet me ligj palët në procedurë, se ka komunikuar me palën ex-parte lidhur me lëndën apo se ka shkelë nenin 24 (*Barazia para Ligjit*) dhe 31 (*E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm*) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu siç pretendon ankuesi në parashtrësën e tij. Andaj, autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari A.H ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7 paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - AD/GJTHPR/.nr.20/24, me datë 27.09.2024

Kryetarja e Gjykatës

Albina Shabani Rama

Vendimi i dorëzohet:

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Gjyqtarit A.H*
3. *Parashtruesit të ankesës – H.S*